



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

Nr. 4804.....Prot.

Datë 11/08/2023

**PROJEKT – VENDIM**

**“Për dorëheqjen e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës”**

Në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 49, pika 4, germa b, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, në mbledhjen e radhës me datë \_\_. \_\_. 2023

**PROPOZOJMË**

1. Miratimin e dorëheqjes së anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Z. Sander Nikolli.

**Kryetari Këshillit**

**Ervis Shimaj**





Nr. 455  
Dt. 24.07.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE SHKODËR

NOTER LUMTURI HOXHA  
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE  
SHKODER, RR. DON BOSKO  
TEL: 0692076263

# DEKLARATË NOTERIALE

(DEKLARATË ME PËRMBAJTJE TË TJERA)

Nr. repertori: 2981

Nr. koleksioni: 938

Shkoder më 21/07/2023

Lumturi  
Hoxha

Firmosur elektronikisht nga  
NISA me certifikaten  
:Lumturi Hoxha  
Data: 2023.07.21  
14:39:17+02:00

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

\*Ky material përbëhet nga 3 flete



A2023043760102327342



## DEKLARATË NOTERIALE

Sot, më datë 21 Korrik 2023, ditën e Premte, para meje Notere Lumturi Hoxha, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Shkodër, me zyrë në adresën Shkodër, Njesia Administrative Shkodër, Rr. Don Bosko, u paraqit personalisht:

### DEKLARUES:

**Sander Nikolli**, atësia Ndue, amësia Drande, shtetas Shqiptar, lindur në Mnelë, Shkodër dhe banues në VAU-DEJËS, me adresë Rrethit 03510036; Nd. 26; H. 1; Vig-Mnelë; Mnelë E Madhe; 4028; Vau-Dejës, lindur më 01/05/1967, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036195755 dhe nr. personal **G70501222G**

I cili nën përgjegjësinë e tij personale dhe në vullnet të lirë e të plotë, në bazë të nenit 79 të Kodit Civil Shqiptar, nenit 62, 63, të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", më deklaroi si më poshtë vijon:

Unë i nënshkruari Sander Nikolli deklaroj nën përgjegjësinë time personale se prej pesë vitesh kam ushtruar funksionin e Anëtarit të Këshillit Bashkiak në Bashkinë Vau Dejës. Këtë detyrë e kam ushtruar nën përgjegjësinë time më të lartë personale e morale. Ka qenë një nder i madh për mua të kontribuoja në marrjen e vendimeve më të mira për vendin tim. Për arsye personale nga kjo detyrë kam vendosur të dorëhiqem.

Deklaroj se edhe pse po dorëhiqem nga kjo detyrë, nuk do të tërhiqem nga vullneti i mirë dhe përpjekja për të shërbyer në të mirë të vendit tim.

E bej këtë deklaratë për ta paraqitur ku të jetë e nevojshme. Keto janë theniet e mija dhe i nënshkruaj me vullnetin tim të lirë.

Deklarata e mësipërme, u hartua në gjuhën shqipe dhe u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të deklaruesit të mësipërm. Pasi ai deklaroi se u njoh dhe i kuptoi efektet juridike të aktit, e nënshkroi atë rregullisht përpara meje Noteres. Kjo deklaratë, u hartua nga unë Noterja në 2 (dy) kopje, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të deklaruesit. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale dhe tjetra i vihen në dispozicion deklaruesit. Bashkëlidhur deklaratës gjendet dokumentacioni i mëposhtëm: Kopje e mjetit të identifikimit të personit të paraqitur;

Unë Noterja, verifikova identitetin e tij nëpërmjet dokumenteve të identitetit cituar më sipër dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, germa "ll", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e deklaruesit. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të kësaj deklarate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

### DEKLARUES

Sander Nikolli

NOTERE  
LUMTUR HOXHA



LETËRNJOFTIM ID REPUBLIKA E SHqipëRIE REPUBLIC OF ALBANIA

national surname  
**Nikolli**  
given name  
**Sander**  
nationality  
**Shqiptare/Albanian**  
year of birth  
**01-05-1967**  
month of birth  
**05**  
day of birth  
**01**  
sex  
**M**  
date of validity of entry  
**12-07-2030**  
or personal identification  
**G70501222G**

signature  
*Sander Nikolli*  
MPB

